



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 3.11.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Floriana Merovci, ZPRK; Etrur Maloku, Ambasada Amerikane; Drilon Asllani, Radio “Dukagjini”; Besmir Korollani, Instituti “TACHAT”; Agron Beka, SHPRK; Petrit Hysaj-OSBE; Nora Kelmendi, KDI; Baki Gimolli, MD; Norë Shahini, gazeta “Koha Ditore”; Armend Zenelaj, BIRN; Besarta Maliqi, gazeta “Tribuna”; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 30 qershor dhe 1,6,10,15,27,29,30 korrik, 2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
4. Njoftim me Raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, lidhur me numrin e lëndëve të përfaqësuara në gjykata dhe lëndëve të vendosura në favor të palëve të përfaqësuara, që nga themelimi i Agjencisë;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja propozoi që të shtohet edhe pika:”5. Shqyrtimi i propozimit të Ministrisë për komunitete dhe kthim për emërimin e anëtarit të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas”.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 30 qershor dhe 1,6,10,15,27,29,30 korrik, 2015

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 30 qershor dhe 1,6,10,15,27,29,30 korrik, 2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryesuesja, tha se ju e dini që ky ligj nuk ka shumë kohë që është ndryshuar dhe tani kemi një projektligj tjetër për ndryshim dhe plotësim. Po ashtu, e njoftoi Komisionin me përmbajtjen e projektligjit, duke shtuar se njëjti i plotëson kushtet për shqyrtim në parim dhe rekomandoi të formohen edhe një grup punues, të cilin do ta kryesojë z. Armend Zemaj.

Armend Zemaj, tha se do ta kryesoj këtë grup dhe do t’i analizojmë seriozisht këto ndryshime, me të gjithë aktorët, kuptohet pas miratimit në parim, dhe të shohim se cili ka qenë qëllimi i ndryshimeve të propozuara. Kjo, pasi që neni 1 i projektligjit që flet për mandatin e anëtarëve, është konfuz dhe duhet të qartësohet.

Agim Aliu, ishte i mendimit që projektligji duhet të përkrahet në parim dhe se bëhet fjalë për një projektligj me një materie jo shumë voluminoze dhe se grupi punues do të ketë mundësi që me sponsorin, të sqarojë qëllimin e projektligjit.

Komisioni për shqyrtim të këtij projektligji, formoi grupin punues në përbërje: Armend Zemaj, kryesues, Selvije Halimi dhe Danush Ademi-anëtarë.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

4. Njoftim me Raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, lidhur me numrin e lëndëve të përfaqësuara në gjykata dhe lëndëve të vendosura në favor të palëve të përfaqësuara, që nga themelimi i Agjencisë

Kryesuesja e njoftoi Komisionin me raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, lidhur me numrin e lëndëve të përfaqësuara në gjykata dhe lëndëve të vendosura në favor të palëve të përfaqësuara, që nga themelimi i Agjencisë. Kjo është më tepër si njoftim për Komisionin, pasi që raportin e punës, tashmë e kemi shqyrtuar dhe miratuar në komision. Një nga rekomandimet e komisionit për Agjencinë ka qenë që ta sjellë një raport të tillë.

Armend Zemaj, tha se raportet e tilla duhet ta kenë një afat të procedimit dhe mos të vijnë me kaq vonese, sepse tani e ka humbur edhe kuptimin e raportit. Në raporte të tilla, kam kërkuar çdoherë që të kemi statistika të qarta se sa njerëzit e shfrytëzojnë ndihmën juridike falas.

Agim Aliu, tha se në raport shihet që Agjencia ka bërë punë të mirë në përfaqësim të palëve. Por, edhe ne kur e kemi shqyrtuar raportin, kemi dhënë rekomandime se si të ndihmohet kjo Agjenci dhe do të duhej të kemi një informatë se deri ku kanë shkuar ato rekomandime që i kemi adresuar për agjencinë. Nuk do të duhej të diskutohej për një raport, që tashmë e kemi miratuar para 5-6 muajve. Më tutje, tha se do të duhej, qoftë në ligj të Kuvendit apo edhe në plotësim të Rregullores së Kuvendit, të parashihet çështje e raportimit të institucioneve të pavarura. Pra, ato raporte të shqyrtohen vetëm nga komisionet, dhe në raste të caktuara kur ato nuk përkrahen nga komisionet, të shkojnë për në Kuvend me rekomandime, dhe në rast mosmiratimi nga Kuvendi, të kërkohen përgjegjësi.

5. Shqyrtimi i propozimit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për emërimin e anëtarit të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Kryesuesja, tha se me qëllim të plotësimit të të gjithë anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, të përcaktohem edhe për kandidatin nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe ftoi znj. Milena Miliçević, të propozojë se cili nga tre kandidatët e propozuar, rekomandohet për emërim në Kuvend.

Milena Miliçević, propozoi që për anëtar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, të jetë Milena Vuçiq.

Danush Ademi, duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve, tha se Ministria për Komunitete dhe Kthim, është dashur që të propozojë edhe emra nga komunitetet tjera, pasi që ka propozuar tre emra nga komuniteti serb.

Pas diskutimeve, Komisioni, në mënyrë unanime e përkrahu propozimin që znj. Milena Vuçiq, të emërohet anëtare e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, propozuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Komisioni vendosi që lista e propozimeve nga radhët e kandidatëve të propozuar nga institucionet e parapara me nenin 11, të Ligjit nr. 04/L-17 për Ndihmë Juridike Falas, të procedohen për emërim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

6. Të ndryshme

Armend Zemaj, propozoj që më 4.11.2015, të mbahet takimi i grupit për hartimin e konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, pasi ky takim nuk po thirret nga kryesuesi, propozoi që të bëhet zëvendësimi. Në cilësi të kryesuesit të grupit punues për Projektligjin për verifikim dhe krahasim të pronës, e njoftoi Komisionin se si grup kemi kërkuar kohë shtesë për të analizuar ekspertizat që janë bërë për këtë projektligj, si dhe zhvillimet tjera që janë të ndërlidhura me këtë projektligj.

Komisioni vendosi që të bëjë zëvendësimin e kryesuesit të grupit punues për përgatitjen e tekstit të konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe ngarkoi znj. Selviqe Halimi, që ta kryesojë. Përbërja tjetër e grupit punues mbetet e njëjtë, sipas vendimit të Komisionit, të datës 29.7.2015.

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të mbahet më 10.11.2015, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selviqe Halimi